

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5525  
E premte, 13 korrik 2018  
çmimi 0.40 €

## Zjarrfikësit kërkojnë plotësimin e kërkesave



Zjarrfikësit nga të gjitha komunat e Kosovës kanë protestuar të enjten në Prishtinë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar kushte më të mira për punë dhe rritje të pagave ■ FAQE 6

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**REKOMANDIMET TË KORRESPONDHEN ME REFERENCAT E STUDIMIT** F.11



Hajdin ABAZI

**HARADINAJ KRITIKOHET NGA OPOZITA PËR PRITJEN E RADOJÇIQIT NË QEVERI** F.2

**PËR NJË VIT NË KOSOVË REGJISTROHEN MBI 17 MIJË MARTESA** F.6

**EKIPI PËRGATITOR PËR KOMISIONIN PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN MIRATOI PLANIN E PUNËS** F.4

## EKONOMI

**2.3 MILIONË EURO PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT TË NGROHTORES QENDRORE NË PRISHTINË** F.8

**BERAT RUKIQI PRANON DETYRËN E KRYETARIT TË OEK-ut** F.9

## SPORT

**PRISHTINA MUND TË KUALIFIKOHET, DRITA E PAPËRVOJË PËR MALMON** F.16

**KOZNIKU: E LUS ZOTIN QË KROACIA T'I HAKMERRET FRANCËS** F.16



FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP SELIMI ■ FAQE 4-5

## FSK-ja nuk duhet të bëhet pjesë e dialogut

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se nuk është problem largimi i serbëve nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-ja), por mundësia e Serbisë për të ndikuar në institucionet e sigurisë së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai

ka paralajmëruar se e njëjta gjë mund të ndodhë edhe në Policinë e Kosovës. Selimi ka bërë thirrje të mos lejohet që FSK-ja të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se dialogu po vazhdon dhunshëm dhe kundër interesave të Kosovës. Sipas Selimit, dialogu me këtë format dhe me këta

persona nuk duhet të vazhdojë. Ai ka folur edhe për funksionimin e koalicionit qeverisës, duke thënë se ky koalicion tashmë ka humbur shumicën, prandaj sa më parë duhet të shkohet në zgjedhje. Selimi ka theksuar se zgjedhjet janë e vetnja mundësi për të dalë nga kjo situatë

## Thaçi: Kosova ka vija të kuqe në dialogun me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se Kosova i ka vijat e kuqe për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë. Duke folur për takimin e dytë të kësaj faze me presidentin serb në Bruksel që do të mbahet javën e ardhshme, presidenti Thaçi ka thënë se asnjëherë nuk do të

ketë amnisti për ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit në Kosovë. "Për shtetin e Kosovës ekziston vijë e kuqe e qartë. Ky proces duhet të përmbyllet me marrëveshje përfundimtare, me marrëveshje finale, historike, të njohjes nga Serbia për shtetin e Kosovës", ka thënë Thaçi ■ FAQE 3



## Deputetët Berisha e Arifi i bashkohen grupit parlamentar të Nismës

Nisma Socialdemokrate ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha dhe kryetarin e Partisë së Ashkalive për Integrim, Etem Arifi. Me

anë të kësaj marrëveshje deputetët Veton Berisha dhe Etem Arifi pajtohen të bashkëngjiten dhe të veprojnë në kuadër të grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate ■ FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)


**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Haradinaj kritikohet nga opozita për pritjen e Radojçiqit në Qeveri

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të enjten një takim pune me kryetarin e Listës Serbe, Goran Rakiq dhe nënkryetarin e këtij subjekti, Milan Radojçiq, me të cilët është diskutuar për situatën e përgjithshme në vend, me theks të veçantë për aspektet e sigurisë si dhe zhvillimit ekonomik e social. Ndërkaq opozita nuk e ka mirëpritur takimin e kryeministrit me përfaqësuesit e Listës Serbe, veçanërisht pritjes që i është bërë Milan Radojçiqit



**PRISHTINË, 12 KORRIK (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të enjten një takim pune me kryetarin e Listës Serbe, Goran Rakiq dhe nënkryetarin e këtij subjekti, Milan Radojçiq. Zyra për Informim e Qeverisë së Kosovës ka njoftuar se në këtë takim është diskutuar për situatën e përgjithshme në vend, me theks të veçantë për aspektet e sigurisë si dhe zhvillimit ekonomik e social. Por, opozita nuk e ka pritur mirë këtë takim të Haradinajt me përfaqësuesit e Listës Serbe, veçanërisht pritjes që i është bërë Milan Radojçiqit. Deputeti i Lidhjes Demokratike të

Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka akuzuar partinë e Ramush Haradinajt për lidhje me Listën Serbe. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Zemaj ka thënë se kjo është fytyra e vërtetë e AAK-së. "Paradite akuzuan për aleancë me Listën Serbe. Ashtu siç ju thashë, ky është në vetëdijen tuaj si gjithmonë për t'u mbrojtur nga shkeljet e vazhdueshme ligjore të këtyre individëve dhe strukturave qeveritare. Kjo u dëshmuua menjëherë pasdite, duke pritur në mënyrë solemne të dyshuarin për krim të organizuar, zhvatje, dhunë dhe frikësim të qytetarëve të Mitrovicës veriore, Milan

Radojçiqin. Kjo është fytyra e vërtetë", ka shkruar deputeti Zemaj. Lista Serbe përfaqësohet me një zëvendëskryeministër, tre ministra dhe disa zëvendësministra në Qeverinë e Kosovës. Por, ministrat serbë janë duke funksionuar nga pozita e ministrave në dorëheqje, ndërkaq në Kuvend deputetët e Listës Serbe kanë kaluar në opozitë. Këto qëndrime Lista Serbe i ka marrë pas arrestimit të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, më 26 mars. Aktualisht, përfaqësuesit e Listës Serbe janë të përfshirë edhe në hartimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

## LAJME SHKURT

### Maqedonia merr zyrtarisht ftesën për në NATO



**BRUKSEL, 12 KORRIK** - Maqedonia zyrtarisht mori ftesën për anëtarësim në NATO. Ftesa tashmë është në duart e kryeministrit Zaev, të cilën e ka vlerësuar historike dhe si ftesë që garanton të ardhme më të mirë për qytetarët e Maqedonisë. Sipas Zaevit, Maqedonia me anëtarësimin në NATO bëhet më e sigurt dhe bashkë me NATO-n bëhet pjesë e mekanizmit ndërkombëtar për t'i luftuar kërcënimet globale siç janë terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. "Të jeni të sigurt se anëtarësimi ynë edhe më shumë do ta konsolidojë demokracinë në rajon dhe do ta rrisë stabilitetin dhe sigurinë e rajonit dhe do të shërbejë si shembull pozitiv për Ballkanin Perëndimor. Angazhimi i fuqishëm i qeverisë për t'i zgjidhur çështjet e hapura me fqinjët dha rezultate. Shpreh falënderime ndaj kryeministrit grek Cipras dhe atij bullgar Borisov për ndarjen e vizionit të përbashkët me ne, vizion ky që sjell sukses në rajon dhe në Evropë", deklaroi kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jon Stoltenbergu, tha se të gjithë në Maqedoni duhet t'i gëzohen ditës së sotme. "Besoj se marrëveshja për emrin është në të mirën e vendit tuaj dhe të rajonit më të gjerë. Ju përgëzoj për guximin politik dhe i përgëzoj të gjithë ata që morën pjesë për përkushtimin për ardhmëri më të mirë. Ky kompromis i hapi rrugën vendit tuaj që të bëheni anëtar i plot-fuqishëm i NATO-s", deklaroi Jon Stoltenberg, sekretar i përgjithshëm i NATO-s. Ai njoftoi se pas bisedimeve teknike do të fillojnë përgatitjet për anëtarësim të plotë të Maqedonisë në NATO si vend i 30, me të drejtë vote të barabartë në Aleancë.

### Ahmeti: Integrimi në NATO siguron paqe të qëndrueshme



Shkup, 12 korrik - Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ka përgëzuar qytetarët e Maqedonisë me rastin e marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, duke thënë se kjo është një arritje e rëndësishme për të ardhmen e sigurt të vendit. Ai tha se integrimi i plotë i Maqedonisë dhe rajonit në NATO mundëson siguri, stabilitet, paqe të qëndrueshme, marrëdhënie të mira ndëretnike, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie shoqërore. "Arritjet e këtij viti, të cilat mundësojnë barazi dhe integrim euroatlantik, janë synim i të gjithë qytetarëve dhe partive politike në vend, prandaj të gjithë ne bashkërisht duhet të punojmë për rrumbullakim të suksesshëm të këtij procesi. Këto arritje janë rezultat i punës së përbashkët të qytetarëve tanë, partive politike, shoqërisë civile, botës akademike, medieve dhe miqve ndërkombëtarë. Kjo ëndërr e qytetarëve tanë që ka filluar të realizohet sot kërkon nga ne që të bashkohemi rreth Maqedonisë euroatlantike", ka thënë Ahmeti.

## Basha: Për terrorizmin të kemi qëndrim unik në NATO

Tiranë, 12 korrik - Teksa gjysma e Qeverisë prej më se një jave gjendet jashtë vendit, si pasojë e pjesëmarrjes në dy samite të rëndësishme si ai i Ballkanit Perëndimor në Londër dhe i NATO-s në Bruksel, një agjendë thaujse të ngjashme duket se ka pasur edhe kryedemokrati Lulzim Basha. Ai ka nisur vizitën e paralajmëruar në Uashington, ku të enjten ka marrë pjesë në ngjarjen e Institutit Hudson, me temë diskutimi arritjet e Samitit



të NATO-s, ku rivali i tij politik, Edi Rama, u ul në tryezë bisedimesh me liderët e aleancës. Të pranishëm në të njëjtin

diskutim me Bashën kanë qenë anëtarë të Kongresit amerikan si dhe senatorë. "Terrorizmi dhe korrupsioni janë një kërcënim për demokracinë, ndërsa NATO-ja është një mekanizëm me rëndësi për paqen dhe stabilitetin. Përkushtimi i vendeve është i nevojshëm dhe i shërben stabilitetit dhe paqes. Duhet të kemi një qëndrim unik në NATO dhe të përpiqemi që aleancën ta bëjmë më të fortë", tha Basha në fjalën e tij.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka folur rreth takimit të ardhshëm Kosovë - Serbi

# Thaçi: Kosova ka vija të kuqe në dialogun me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se Kosova i ka vijat e kuqe për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë. Duke folur për takimin e dytë të kësaj faze me presidentin serb në Bruksel që do të mbahet javën e ardhshme, presidenti Thaçi ka thënë se asnjëherë nuk do të ketë amnisti për ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit në Kosovë. "Për shtetin e Kosovës ekziston vijë e kuqe e qartë. Ky proces duhet të përmbillet me marrëveshje përfundimtare, me marrëveshje finale, historike, të njohjes nga Serbia për shtetin e Kosovës", ka thënë Thaçi



**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 12 KORRIK** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se Kosova ka vija të kuqe edhe në fazën e fundit të dialogut me Serbinë. Ai ka deklaruar se këto vija do të respektohen dhe ky proces do të mbyllet me njohjen reciproke të dy vendeve. "Për shtetin e Kosovës ekziston vijë e kuqe e qartë. Ky proces duhet të përmbillet me marrëveshje përfundimtare, me marrëveshje finale, historike, të njohjes nga Serbia për shtetin e Kosovës. Asnjë marrëveshje tjetër nuk e ka ndonjë vlerë apo ndonjë marrëveshje të përkohshme eventuale që do të mund të ishte. Pra, marrëveshja do të jetë finale dhe e njohjes reciproke", ka deklaruar Thaçi të enjten teksa ka vizituar fabrikën "Kivo" në Kaçanik. Shefi i shtetit, duke folur për takimin e ardhshëm me homolo-

gun serb, i cili do të mbahet më 18 korrik në Bruksel, ka theksuar se ende nuk kanë në tavolinë ndonjë substancë rreth marrëveshjes përfundimtare në mes të dy vendeve. "Vazhdimisht diskutohet për implementimin e marrëveshjeve të arritura më herët, por më datën 18 do të jetë takimi i dytë i radhës i fazës finale për arritjen e marrëveshjes në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Ende nuk kemi ndonjë substancë në tavolinë për të diskutuar, por do të kemi një orientim për kornizimin e vijave të përgjithshme të këtij procesi dhe për të diskutuar për hapat dhe për dinamikën e mëtejshme që do të vazhdojë pas pushimeve verore", ka thënë ai. Sipas presidentit të vendit, asnjëherë nuk do të ketë amnisti për ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit në Kosovë dhe që kanë organizuar spastrim etnik. "Pas çdo konflikti që ndodhë nuk është vetëm rasti i Kosovës dhe

Serbisë. Është diskutuar për amnistinë e mundshme. Mund të ketë diskutime në formë të përkallëzimit të amnistisë së pjesëmarrësve në konfliktin e fundit, por një gjë dua të sqaroj, se për ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit, kanë organizuar spastrimin etnik, kanë vrarë mbi 15 000 civilë shqiptarë në Kosovë, kanë kryer mbi 400 masakra ndaj popullatës shqiptare, kanë dhunuar mbi 20 000 femra shqiptare, në asnjë rrethanë nuk do të ketë amnisti. Ata duhet të ballafaqohen me drejtësinë, duhet të ballafaqohen sa më shpejt që është e mundur. Kështu që, për njerëzit që kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe kanë organizuar spastrimin etnik, në asnjë rrethanë nuk do të ketë amnisti", ka deklaruar Thaçi.

Ndërsa kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i ka dhënë përkrahje presidentit në këtë proces. Sipas kreut të Qeverisë, Kosova në këtë fazë të dialogut duhet të përfaqësohet nga institucionet dhe pjesë e këtij procesi duhet të jetë edhe opozita. "Mendoj se Kosova s'mund të kthehet më prapa, në kohën e para shtetësisë, pra përfaqësimi i Kosovës duhet të ndodhë përmes institucioneve", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se edhe tek opozita tani është një klimë më e mirë për t'iu bashkuar procesit. "U kam bërë apel me kohë partive politike opozitare që ta përkrahin Kosovën vetëm që Kosova ta kryejë një temë të rëndësishme, në këtë rast ta përmbillet dialogun. Mendoj se është një klimë më e mirë tash, pas konsultave që kam pasur. Kosova

përfaqësohet nga institucionet e vendit të cilave u prin presidenti në bazë të Kushtetutës. Njëkohësisht edhe partitë politike parlamentare janë të nevojshme, edhe LDK-ja, PSD-ja dhe LV-ja", ka thënë ai. Haradinaj ka bërë me dije se subjekti i tij politik do të jetë pjesë e këtij procesi. Në konferencën për medie, pas kthimit nga Samiti i Londrës, kryeministri Haradinaj ka folur edhe për rolin e Gjermanisë, të Britanisë dhe të ShBA-së në dialogun me Serbinë. "Në dialogun me Serbinë, Gjermania është faktor i rëndësishëm. Është shumë i nevojshëm roli i kancelares Merkel, i Britanisë dhe Uashingtonit. Pa hyrë të mëdhenjtë në punë nuk besoj se kjo punë kryhet", është shprehur Haradinaj.

## Zëvendëskryeministri Limaj i ofron përkrahje Agim Bahtirit

**MITROVICË, 12 KORRIK (ER)** - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i shoqëruar nga ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, deputeti Enver Hoti dhe bashkëpunëtorët e tjerë, kanë qëndruar të enjten në Mitrovicë, me ç'rast janë pritur nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri. Kryetari Bahtiri e ka njoftuar zëvendëskryeministrin Limaj me punën që është duke u bërë në Mitrovicë, për problemet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet. Ai i ka thënë Limajt se në vitin 2013 kur është zgjedhur kryetar i Mitrovicës, gjendja në këtë komunë ka qenë jashtëzakonisht e rëndë në të gjitha fushat. Bahtiri para ministrit të Arsimit ka paraqitur kërkesën për ndër-

timin e shkollës në Gushafc, e cila është në gjendje pothuajse të papërdorshme, duke vlerësuar se ndërtimi i kësaj shkolle është edhe interes strategjik. Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se ardhja e Bahtirit në krye të Mitrovicës ka bërë që ky qytet të ndryshohet për të mirë. "Keni bërë punë të mëdha dhe ju përgëzoj. Gjithmonë do ta keni mbështetjen time për idetë, vizionin dhe projektet tuaja. Vështirë e ke pasur, por ia ke dalë me sukses", ka thënë Limaj. Limaj dhe Bytyqi i thanë kryetarit Bahtiri se sa i përket ndërtimit të shkollës në Gushafc, do të angazhohen për të siguruar mjete, aq më tepër kur ndërtimi i kësaj shkolle në këtë fshat është një investim strategjik.



Flet për "Epokën e re", Rexhep Selimi

# FSK-ja nuk duhet të b

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se nuk është problem largimi i serbëve nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-ja), por mundësia e Serbisë për të ndikuar në institucionet e sigurisë së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka paralajmëruar se e njëjta gjë mund të ndodhë edhe në Policinë e Kosovës. Selimi ka bërë thirrje të mos lejohet që FSK-ja të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se dialogu po vazhdon dhunshëm dhe kundër interesave të Kosovës. Sipas Selimit, dialogu me këtë format dhe me këta persona nuk duhet të vazhdojë. Ai ka folur edhe për funksionimin e koalicionit qeverisës, duke thënë se ky koalicion tashmë ka humbur shumicën, prandaj sa më parë duhet të shkohet në zgjedhje. Selimi ka theksuar se zgjedhjet janë e vetmja mundësi për të dalë nga kjo situatë



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 KORRIK -

**"Epoka e re":** Z. Selimi sa janë shqetësuese largimet e pjesëtarëve serbë nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-ja)?

**Selimi:** Largimi i pjesëtarëve serbë nga FSK-ja është shqetësues, por nuk është problemi kryesor. Problemi kryesor është mundësia e Serbisë për të ndikuar në institucionet e Kosovës, në këtë rast në institucionet e sigurisë siç është FSK-ja. Është proklamuar në vazhdimësi si arritje e madhe integrimi i serbëve në FSK, mirëpo me një urdhër të Vuçiqit çështja kthehet në pikën zero. Prandaj një mund i madh paska qenë në dorë të Serbisë, ashtu siç është edhe themelimi i ushtrisë së Kosovës nëse u referohemi të drejtave që ata kanë në Kuvend përmes Listës Serbe.

**"Epoka e re":** Kjo situatë prodhon efekt negativ në procesin e transformimit të FSK-së?

**Selimi:** Gjithsesi do të ketë për arsyen se kemi qenë në pritje të hapave konkretë të institucioneve të Kosovës për avancimin e rolit të FSK-së në Forca të Armatosura dhe prej që ka filluar ky problem askush nuk flet e nuk angazhohet më për avancimin, por për rikthimin në gjendjen e mëparshme. Kjo krijon situatë të pafavorshme të Kosovës edhe me partnerët strategjikë të cilët

punuan shumë që FSK-ja të ngrihet në këtë nivel që është sot si një platformë për të shkuar drejt ushtrisë. Kemi bërë regres në këtë temë dhe tani flitet për 40 serbë dhe jo për qëllimet e objektivat që do të duhej të kishte Qeveria e Kosovës për Forcat e Armatosura.

**"Epoka e re":** Kjo ndërhyrje e Beogradit ka për qëllim që FSK-ja të bëhet pjesë e dialogut?

**Selimi:** Ne do të pësojmë nëse FSK-ja shkon në tavolinën e dialogut. Prandaj nuk duhet të lejojmë që FSK-ja të bëhet pjesë e dialogut. Sot Serbia në tavolinë është duke diskutuar sovranitetin e Republikës së Kosovës për ta pamundësuar atë dhe jo për ta avancuar. Edhe funksionimin e drejtësisë dhe të institucioneve i ka në tavolinë për t'i penguar. Kurdo që ta ketë FSK-në në tavolinë do ta asgjësojë apo, siç thonë, do ta pamundësojnë që Kosova të ketë ushtri. Problemi do të jetë më i madh nëse lejohet që negociatorët ta kenë në tavolinë çështjen e ushtrisë sepse atëherë ka të bëjë drejtpërdrejt me siguri dhe me garantuesin e sovranitetit. Nëse diskutohet garantuesi i sovranitetit siç është ushtria, atëherë diskutohet edhe sovraniteti. Për FSK-në dhe për Kosovën ne duhet të flasim me përkrahësit dhe jo me kundërshtarët. Sa herë që flasim me Serbinë për çështje të brendshme, pëson Kosova dhe jo Serbia.

**"Epoka e re":** Si duhet të veprojë Kosova për ta pamundësuar shkuarjen e ushtrisë në bisedime?

**Selimi:** Duhet ta vazhdojë rrugën në partneritet me aleatët strategjikë sepse në këtë formë kemi ardhur deri këtu. Duhet një përkushtim maksimal për respektimin e Kushtetutës, sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës.

**"Epoka e re":** Drejtuesit e FSK-së kanë bërë me dije se nuk do

të jetë problem zëvendësimi i pjesëtarëve serbë si dhe këto largime nuk do të kenë efekt në procesin e transformimit.

**Selimi:** Edhe unë them se nuk është problem zëvendësimi i tyre, por është mundësia e Serbisë për t'i larguar edhe të tjerët. Nëse Serbia sot ka mundësi që me një urdhër t'i largojë, nesër mund të japë urdhër për rebelim.

**"Epoka e re":** Ka rrezik që e njëjta të ndodhë në Policinë e

Kosovës?

**Selimi:** Po, e njëjta gjendje ka rrezik të përsëritet edhe në Policinë e Kosovës. Madje bëhet më lehtë për shkak se ka një regjion të caktuar të policisë (veriu) që nuk duket se ka lojalitet praktik ndaj institucioneve të Kosovës, dhe këtë lojalitet jo rrallëherë e shpreh ndaj institucioneve të Serbisë, aq më tepër në përputhje me marrëveshjen e prillit të vitit 2013, ku atje është komandanti serb i cili mund të japë urdhra, prandaj

## Ekipi përgatitor për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin miratoi planin e punës

Prishtinë, 12 korrik - Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, i themeluar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur të enjten takimin e rad-

hës dhe ka miratuar rregulloren dhe planin e punës.

Ekipi përgatitor është themeluar për të ndërtuar infrastrukturë teknike e ligjore për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin. Ai

përbëhet nga katër përfaqësues të institucioneve shtetërore, Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, si dhe pesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe ekspertë të proceseve të ballafaqimit me të

kaluarën. Ky ekip vepron që nga 1 maji 2018 dhe takohet në baza të rregullta javore.

Me miratimin e dokumenteve themelore të ekipit përgatitor tani puna do të përqendrohet në për-

gatitjen e akteve juridike, dokumenteve dhe hapësirave të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Ekipi përgatitor ka afat 18 muaj që ta përfundojë punën e vet.

# ëhet pjesë e dialogut

Barazi  
Drejtësi  
Zhvillim

qare dhe me Serbinë nuk duhet të flitet për ndërtimin e brendshëm të Kosovës. Nuk duhet të flitet me armikun më të madh për ndërtimin e shtetit të Kosovës. Ky është gabimi në hapa. Vetëvendosja është në rrugën e njëjtë dhe nuk do të ndryshojë mendim as qasje ndaj këtij procesi. Dialogun e kundërshtojmë për ta mbrojtur interesin e Kosovës. Nga dialogu do të shpëtonim vetëm nëse do të ndërpritej një ditë e më parë.

**"Epoka e re":** Pavarësisht prej kundërshtimit opozitar, dialogu po vazhdon dhe po bëhet thirrje nga faktori ndërkombëtar për arritjen e një konsensusi për fazën finale të tij.

**Selimi:** Dialogu po vazhdon dhunshëm pavarësisht prej kundërshtimeve të opozitës dhe opinionit. Me dhunë po mbahet gjallë dialogu i Thaçit me Vuçiqin, po e quaj kështu sepse Thaçi nuk po i mbron interesat e Kosovës dhe të qytetarëve. Relacioni i Thaçit me Serbinë vazhdon të jetë problemi kryesor. Sa iu përket thirrjeve të bashkësisë ndërkombëtare për konsensus janë normale sepse parimet ndërkombëtare i kanë në fjalorin e vet fjalët pozitive dialog, konsensus, e marrëveshje meqë ata nuk thërrasin për luftë e ekzistencë. Mirëpo ne duhet ta respektojmë Kushtetutën e Kosovës dhe kjo do të duhej të ishte detyra jonë primare.

**"Epoka e re":** Nuk mendoni se do të ishte më mirë të arrihet konsensusi dhe të formohej ekipi nga të gjitha partitë i cili do t'i përcaktonte vijat e kuqe dhe Thaçi ta drejtonte dialogun sipas agjendës së këtij ekipi?

**Selimi:** Dialogu me këtë format dhe me këta persona nuk duhet të vazhdojë. Kosova nuk ka nevojë të flasë me Serbinë për serbët e Kosovës. Duhet ta zhvendosim dialogun mes Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve legjitimë të serbëve të Kosovës dhe jo me marionetën e Serbisë siç është Lista Serbe apo edhe drejtpërdrejt me Serbinë siç është Vuçiqi. Ne kemi alternativë dhe nëse duam t'i integrojmë serbët

e Kosovës, duhet të flasim me ata dhe jo me Beogradin. Në rastin konkret është përjashtuar faktori politik serb i Kosovës dhe është faktorizuar faktori politik i Beogradit në Kosovë. Ky është sulmi më i madh që i ka ndodhur ndonjëherë pavarësisë së Kosovës. Çdo marrëveshje e arritur do të jetë jolegjitime dhe e papranueshme. Nuk do t'i falet kujtdo që merr vendime në dëm të interesave të shtetit të Kosovës.

**"Epoka e re":** Pse ju si opozitë nuk po dilni me një alternativë konkrete për udhëheqjen e dialogut?

**Selimi:** Ne kemi dalë me alternativë dhe alternativa jonë është të mos flasim me Serbinë, por me serbët e Kosovës. Të mos flasim me kundërshtarët, por me partnerët e pavarësisë. Nuk është problem vetëm personi, por edhe formati dhe segmenti i dialogut. Nuk kemi nevojë ta zëvendësojmë Thaçin në të njëjtin kurs sepse njëherë duhet ta ndryshojmë kursin, pastaj personin.

**"Epoka e re":** Presidenti Thaçi ka shprehur optimizëm se ky dialog do të përfundojë me një marrëveshje e cila i mundëson Kosovës pranimin në NATO, BE dhe OKB.

**Selimi:** Të gjitha janë gënjeshtra. Ky është kamufllim i mashtrimeve që bën ai para vendimeve të këqija. Zaten ai ka paralajmëruar se do të ketë vendime të këqija. Epilogu i këtij dialogu do të jetë realizim i interesave të Serbisë në Kosovë. Kosova nuk do të duhej ta kishte në varësi raportin me Serbinë për anëtarësim në BE sepse nuk bënë kështu shtetet që dolën nga ish-Jugosllavia e që sot janë anëtare të BE-së. Nëse e kemi varësinë e anëtarësimit në OKB nga Serbia, atëherë kjo nënkupton se edhe në të ardhmen do të jemi të varur nga ajo.

**"Epoka e re":** Mund të korrigjohen gabimet meqë marrëveshjet e arritura kërkojnë aprovimin e Kuvendit?

**Selimi:** Kuvendi është anashkaluar, po anashkalohet dhe do të anashkalohet edhe

më tutje. Edhe nëse nuk anashkalohet e dimë nga e kaluara se si presioni i faktorëve të ndryshëm ka bërë që të merren vendime të rënda.

**"Epoka e re":** Për ta ndalë dialogun është e vetmja mënyrë shkarkimi i presidentit?

**Selimi:** Presidenti në radhë të parë do të duhej të përgjigjej para gjykatës për dëmet që ia ka shkaktuar Kosovës, njëkohësisht t'i pamundësohet shkaktimi i dëmeve të tjera. Aleanca në mes të këqijve po duket të jetë goxha e qëndrueshme. Vetëvendosja as nuk e ka votuar dhe as nuk po e mban president Thaçin. Dihet kush e ka votuar dhe kush po e mban president. Për ne qysh nesër do të duhej të shkarkohej presidenti dhe të jepte përgjegjësi për atë që i ka bërë Kosovës duke shkëlur Kushtetutën nga pozicioni i kryeministrit dhe i presidentit.

**"Epoka e re":** Z. Selimi, si e komentoni funksionimin e koalicionit qeverisës dhe si opozitë a e keni në agjendë ngritjen e mocionit për rrëzimin e Qeverisë?

**Selimi:** Qeveria e Kosovës po vazhdon të jetë Qeveria e pakicës në Kuvend. Ajo përfaqësohet nga pakica jo vetëm për shkak të largimit të deputetëve serbë, por edhe të rrethanave të tjera. Mazhoranca nuk është e gatshme t'i kalojë projektligjet për të cilat kërkohet shumica e thjeshtë e votave. Kjo do të duhej të mjaftonte që të shkohet në zgjedhje menjëherë. Prandaj menjëherë kjo Qeveria do të duhej të shkonte në dorëheqje, Kuvendi të shpërndahej dhe sa më shpejt të kemi zgjedhje. Vetëvendosja është e gatshme qysh sot ta ketë datën e zgjedhjeve si e vetmja mundësi për të dalë nga kjo situatë.

**"Epoka e re":** Pse Vetëvendosja nuk po e inicion mocionin për rrëzimin e Qeverisë?

**Selimi:** Nuk varet vetëm nga ne, por edhe nga të tjerët. Prandaj do të duhej të koordinoheshim me të tjerët, mirëpo duket që gatishmërinë e tyre nuk e kanë në nivel tash për tash.

më rrezik është te policia sesa te ushtria.

**"Epoka e re":** Pas këtyre ndërhyrjeve dhe pengesave, duhet të vazhdojë dialogu?

**Selimi:** Dialogu po vazhdon dhunshëm dhe kundër interesave të Kosovës. Dialogu në këtë nivel dhe drejtim i konvenon vetëm Serbisë. Çështjet që trajtohen në dialog janë të dizajnuara dhe të sponsorizuara nga Beogradi. Janë kërkesat e Beogradit që, pas shpalljes së pavarësisë së

Kosovës, të diskutohet për, siç i quajnë ata, raporte normale që, në fakt, nuk janë të tilla sepse nuk krijohen kështu raportet normale. Lëvizja Vetëvendosje që nga fillimi ka qenë kundër këtij dialog dhe, për fat të keq, nuk na ka demantuar koha sepse ato që kemi paralajmëruar se do t'i prodhojë dialogu, tashmë i ka prodhuar. Ata që dëshirojnë ta mbrojnë dialogun thonë se është e domosdoshme dhe nuk kemi qare pa folur me Serbinë, por ne mendojmë se ka

## AAK-ja inicion rezolutë: Liberalizimi i vizave, para dialogut

PRISHTINE, 12 KORRIK (ER) - Deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë dorëzuar sot projektrezolutën përmes së cilës kanë kërkuar nga Qeveria të mos

fillohet dialogu me Serbinë derisa të merret vendimi përfundimtar për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës. "Së bashku me kolegët e grupit parlamentar të

AAK-së dorëzuar projektrezolutën dhe kërkuam nga Qeveria të mos fillohet dialogu me Republikën e Serbisë derisa të merret vendimi përfundimtar për heqjen e regjimit të

vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës në Zonën Shengen", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" deputetja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi.



# Zjarrfikësit kërkojnë plotësimin e kërkesave

Zjarrfikësit nga të gjitha komunat e Kosovës kanë protestuar të enjten në Prishtinë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar kushte më të mira për punë dhe rritje të pagave. Kryeministri Ramush Haradinaj u ka premtuar se brenda dy javësh kërkesat e zjarrfikësve do të diskutohen në mbledhjen e Qeverisë dhe do të ofrohet zgjidhje për këtë sektor mjaft të rëndësishëm për vendin



**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 KORRIK - Me thirrjet "Ne jemi shpëtimtarë dhe ne shpëtojmë jetë", zjarrfikësit nga të gjitha komunat e Kosovës kanë protestuar të enjten para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar kushte më të mira për punë. Kërkesat e tyre janë që të rregullohet statusi i zjarrfikësit, definimi i kompetencave menaxhuese, të sigurohet vija buxhetore, të bëhet nivelizimi i pagave në nivel vendi pasi që zjarrfikësit nuk kanë koeficient të njëjtë nëpër komuna, të kompensohen ndërrimet e natës, ato gjatë festave

shtetërore dhe fetare dhe orët jashtë orarit, të përmirësohen kushtet e punës si dhe të sigurohen pajisje dhe mjeteve për punë.

Kryeministri Haradinaj ka zbritur nga ndërtesa për të bashkëbiseduar me zjarrfikësit, ku pastaj i ka ftuar ata në një takim të përbashkët në ndërtesën e Qeverisë. Kryeministri Haradinaj u premtoi se brenda dy javësh kërkesat e zjarrfikësve do të diskutohen në mbledhjen e Qeverisë dhe do të ofrohet zgjidhje për këtë sektor mjaft të rëndësishëm për vendin. "Qeveria e Kosovës është shtëpia juaj dhe nga këtu do të gjendet zgjidhja për prob-

lemet që i keni, e të cilat datojnë që nga viti 2008", është shprehur Haradinaj.

Meqenëse në Kosovë numri i zjarrfikësve nuk është shumë i madh, kryeministri Haradinaj ka thënë se është më lehtë të menaxheshëm dhe ka kërkuar nga ta mirëkuptim, pasi që Qeveria

është në hartim të një koncept dokumenti i cili do t'i rregullojë në mënyrë afatgjatë problemet me të cilat ballafaqohen zjarrfikësit në Kosovë.

Përfaqësuesi i Sindikatës së Zjarrfikësve, Muharrem Beka, ka numëruar disa nga kërkesat prioritare, si: rritja e pagesës për

rrezikshmëri në punë, ngritja e koeficientit deri në hyrjen në fuqi të ligjit për paga, kompensimi i ndërrimit të natës dhe i punës jashtë orarit. Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se është i përkushtuar për ofrimin e një zgjidhje afatgjatë dhe përmes ligjit.

## Për një vit në Kosovë regjistrohen mbi 17 mijë martesë

**EPOKA E RE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 12 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e kurorëzimeve në Kosovë" për vitin 2017. Të dhënat në këtë publikim si bazë kanë të dhënat administrative të marra nga zyrat e gjendjes civile në Kosovë. Në vitin 2017 janë grumbulluar gjithsej 18 642 fleta statistikore për kurorëzime, DEM-3. Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë në vitin 2017 janë kurorëzuar 17 112 çifte bashkëshortore. Sipas përbërjes etnike, del se me përkatësi etnike shqiptare janë kurorëzuar 93.3 për qind femra dhe 95.7 për qind janë meshkuj; me përkatësi etnike serbe janë kurorëzuar 0.9 për qind femra dhe 0.9 për qind meshkuj; me përkatësi etnike turke janë kurorëzuar 0.3 për

qind femra dhe 0.4 për qind meshkuj; me përkatësi etnike boshnjake janë kurorëzuar 1.3 për qind femra dhe 1.2 për qind meshkuj; me përkatësi etnike rome, ashkali dhe egjiptiane janë kurorëzuar 1 për qind femra dhe 1 për qind meshkuj; kurse me përkatësi tjetër etnike janë kurorëzuar 3.1 për qind femra dhe 0.7 për qind meshkuj.

Mosha mesatare e të martuarve ishte 30 vjeç. Prej tyre, mosha mesatare e meshkujve ishte 32 vjeç, ndërsa mosha mesatare e femrave ishte 28 vjeç.

Prej kurorëzimeve, sipas grupmoshave, dominojnë femrat e moshës 20-24-vjeçare me 5 500 ose 32.1 për qind, ndërsa te meshkujt dominon mosha 25-29-vjeçare me 5 278 ose 30.8 për qind. Sipas komunave, Prizreni zë vendin e parë në Kosovë me 1 594 kurorëzime ose 8.6 për qind; Prishtina me 1



420 ose 7.6 për qind; Ferizaj me 1 047 ose 5.6 për qind etj. Sipas përgatitjes shkollore,

dominojnë femrat dhe meshkujt me shkollë të mesme. Numri i femrave të kësaj kate-

gorie është 10 946 ose 64.0 për qind, kurse numri i meshkujve është 12 312 ose 71.9 për qind.

## 30 qendra të mjekësisë familjare furnizohen me insulinë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se më 11 korrik janë furnizuar me insulina të të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare (QKMF)

në 15 komuna. Komunitet, QKMF-të e të cilave janë furnizuar me këtë datë, janë: Podujeva, Kastrioti, Prishtina, Malisheva, Prizreni, Gjakova, Vitia, Novobërda, Gjilani,

Theranda, Mamusha, Dardana dhe Drenasi. Kjo ministri, gjithashtu, ka njoftuar se më 12 korrik janë furnizuar me insulinë edhe

QKMF-të në Rahovec, Ferizaj, Dragash, Fushë-Kosovë, Partesh, Hani i Elezit, Mitrovicë, Skenderaj, Deçan, Istog, Pejë, Junik, Brod, Klinë dhe Graçanicë.



Pas kthimit nga Samiti i Londrës, kryeministri Ramush Haradinaj ka mbajtur të enjten konferencë për medie

## Haradinaj i sigurt se liberalizimi do të ndodhë deri në fundvit

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka shprehur bindje se liberalizimi i vizave do të ndodhë këtë vit. Ai ka bërë me dije se janë në pyetje javët deri kur Kosova do ta marrë rekomandimin pozitiv nga Komisioni Evropian në mënyrë që procesi të mos shtyhet deri në vjeshtë. Sipas tij, Kosovës nuk i rrezikohet liberalizimi i vizave, por çështja mbetet nëse kjo do të ndodhë gjatë vjeshtës apo në fund të vitit



### Samiti i Londrës, i frytshëm

Kryeministri Ramush Haradinaj e ka vlerësuar shumë të frytshëm dhe të rëndësishëm për vendin, Samitin e Londrës, në të cilën Kosova është përfaqësuar nga ai. Haradinaj ka thënë se në kuadër të Samitit të Londrës ka zhvilluar takime bilaterale me udhëheqës të institucioneve të larta të Mbretërisë së Bashkuar. "Ditën e parë të qëndrimit kam zhvilluar takim bilateral me ministrin e Shtetit për Forca të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, Mark Lancaster, me të cilin kam biseduar për tranzicionin e FSK-së dhe

mund të them se në këtë temë me Londrën jemi mirë", ka deklaruar ai. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se në punimet e Samitit të Londrës ka shprehur qëndrimin e Kosovës dhe mirënjohjen për Bashkimin Evropian, vendet e botës, aleatëve për ndihmën që i kanë dhënë Kosovës në çështjen e sigurisë, në fushën politike dhe atë ekonomike. "Kosova sot është e gatshme të bëjë partneritet për këto tema me të gjitha vendet e botës. Pra, nuk jemi vetëm ata që kërkojmë ndihmë, por jemi ata që sot afrohem për partner në temat e sigurisë përmes tranzicionit të FSK-së, në temat ekonomike

përmes investimeve dhe në tema politike, procesin e anëtarësimit", është shprehur Haradinaj. Më tej, kryeministri ka treguar se, përveç pritjes nga nikoqirja, kryeministres së Mbretërisë së Bashkuar, Theresa May, respekt të madh për Kosovën kanë treguar të gjithë pjesëmarrësit në këtë Samit. "Bashkëbisedova me kryeministrin e Polonisë, Greqisë, Serbisë. Me rëndësi ishin dy takimet bilaterale me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel dhe kancelarin e Austrisë, Sebastian Kurz", ka thënë Haradinaj, duke theksuar se në takim me kancelaren Merkel ka biseduar për agjendën evropiane të Kosovës.

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur optimizëm rreth liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ai ka bërë me dije se vendimmarrja për këtë proces është çështje javësh, ndonëse ka pranuar se ende ka punë. "Liberalizimi i vizave nuk është betejë e humbur, por kemi punë. Jemi rrugës, ju kam thënë me kohë, pas komisionit shkojmë në Parlament Evropian. Pas parlamentit kalojmë në Këshill të BE-së, aty janë qeveritë veç e veç dhe aty do të jetë periudha më e vështirë e jona, mirëpo do të punojmë intensivisht më të gjithë", ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie pas kthimit nga Samiti i Londrës.

Ai ka shprehur bindje se liberalizimi do të ndodhë sivjet dhe se BE-ja nuk do ta shtyjë për vitin tjetër vendimin. "Po, po. Lufta po bëhet për javë, pra javët janë në pyetje. Pse? Nëse kishim mundur tani ta kalojmë rekomandimin

nga komisioni në Kuvend, kishim mundur ta zëmë Kuvendin në seanca para pushimit të verës. Tani është me rëndësi për të pasur njerëz që e nxjerrin në agjendë këtë çështje nga njëri institucion tek tjetri. Pra, është një lloj lobimi. Komisionari Avramopoulos është pozitiv, po ashtu komisionari Hahn është pozitiv, por duhet të kalohet procedura e paraparë. Nëse shtyhet për vjeshtë në Kuvend, pak më vështirë është, sepse pastaj hyn edhe klima zgjedhore në BE. Pra, ky proces ka marrë drejtim dhe nuk jemi më në ato etapat që është në pikëpyetje procesi i liberalizimit. Tani është në pikëpyetje afati kohor", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Duke u ndalur tek takimi i zhvilluar në Londër me kancelaren gjermane Angela Merkel, kryeministri Haradinaj ka deklaruar se Merkeli ishte mjaft e kujdesshme, duke thënë se Gjermania e pret fillimisht rekomandimin e Komisionit Evropian dhe më pas do të dalë me qëndrimin e saj.

## Deputetët Berisha e Arifi i bashkohen grupit parlamentar të Nismës

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Nisma Socialdemokrate ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha dhe kryetarin e Partisë së Ashkalive për Integritet, Etem Arifi. Me anë të kësaj marrëveshje deputetët Veton Berisha dhe Etem Arifi pajtohen të bashkëngjiten dhe veprojnë në kuadër të Grupit Parlamentar të Nismës Socialdemokrate. Kështu, numri i grupit parlamentar i Nismës nga gjashtë rritet në tetë. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u ka uruar deputetëve Berisha dhe Etemi mirëseardhje në grupin parlamentar të Nismës. Ndërsa deputetët Berisha dhe Arifi janë shprehur të kënaqur me arritjen e kësaj marrëveshje.

"Ne e kemi mirëpritur këtë marrëveshje për shkak se po i bashkojmë forcat brenda grupit parlamentar të Nismës, me kushtin që bashkë t'i shtyjmë proceset përpara. Komuniteti ynë e ka pritur shumë mirë për faktin se Nisma është një parti socialdemokrate dhe kemi shumë çështje të përbashkëta", ka thënë deputeti Berisha pas nënshkrimit të marrëveshjes. Pas nënshkrimit të marrëveshjes deputetët Berisha dhe Arifi janë pritë në ambientet e Grupit Parlamentar të Nismës nga shefi i këtij grupi parlamentar, Bilall Sherifi dhe deputetët e tjerë të Nismës. Sherifi, ndër të tjera, u zotua se grupi parlamentar i Nismës do t'ua jap gjithë hapësirën e nevojshme deputetit Berisha dhe Arifi në Kuvend dhe në komisione parlamentare.



## 2.3 milionë euro për përmirësimin e rrjetit të ngrohtores qendrore në Prishtinë



Në vlerë prej 2.3 milionë eurosh është nënshkruar të enjten marrëveshja grant për përmirësimin e rrjetit të ngrohtores qendrore në Prishtinë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Donator i këtyre mjeteve është Qeveria e Luksemburgut, kurse përfituese është N. P. "Termokos" Sh. A.

Ambasadën e Luksemburgut Anne Dostert, si dhe përfaqësues të Ndërmarrjes së "Termokos"-it dhe Ambasadës Gjermane.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se kjo marrëveshje u nënshkrua me para pa kthim apo, siç tha ai, "para fal". "Kjo marrëveshje është me para pa kthim apo, siç unë zakonisht i quaj, para fal, nga Luksemburgu. Me këtë rast falënderoj Qeverinë e Luksemburgut dhe taksapaguesit e atij vendi", ka thënë Hamza, duke shtuar se falë kësaj marrëveshje qytetarët e Prishtinës do

të kenë rregullisht ngrohje dhe cilësi më të lartë të ngrohjes. "Qytetarët e Prishtinës e dinë si ka qenë gjendja para projektit të kogjenerimit dhe si pas. Deri më tani nga buxheti i Kosovës janë ndarë 20 milionë euro subvencione me qëllim të përmirësimit të furnizimit me ngrohje", ka thënë Hamza.

Kurse Anne Dostert nga Ambasada e Luksemburgut ka thënë se ndihet e nderuar që falë bashkëpunimit dhe ndihmës së tyre është mundësuar që nga gjashtë orë furnizim sa kishin qytetarët e Prishtinës, të kenë 24

orë furnizim me ngrohje. "Jam shumë e kënaqur që jam sot këtu për të filluar një fazë të re të bashkëpunimit me qëllim të përmirësimit të ngrohjes në Prishtinë. Më kujtohet se që në fillim, kur kemi filluar bashkëpunimin me "Termokos"-in, ka qenë veç gjashtë orë në ditë ngrohja me një nivel të ulët. Përpara kanë pasur gjashtë orë ngrohje, tani kanë 24 orë. Më parë, sipas statistikave, qytetarët ishin të kënaqur vetëm 8 %, kurse sot kjo shifër është 94 %. Sa herë i lexoj këto të dhëna impresionohem", është shprehur Dostert.

**EPOKA ERE****A.MAVRAJ**

**PRISHTINË, 13 KORRIK** - Ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe drejtori i zyrës së KfW-së për Kosovë, Rene Escherman, kanë

nënshkruar të enjten marrëveshjen "Përmirësimi i rrjetit të ngrohtores qendrore në Prishtinë" për zgjerimin e rrjetit të "Termokos"-it në vlerë prej 2.3 milionë eurosh. Pjesëmarrës në këtë marrëveshje ishte dhe e ngarkuara me punë në

## Berat Rukiqi pranon detyrën e kryetarit të OEK-ut

**EPOKA ERE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 13 KORRIK** - Kryetari i deritashëm i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ia ka dorëzuar të enjten në një ceremoni solemne, detyrën kryetarit të sapozgjedhur të kësaj ode, Berat Rukiqi. Ish-kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka uruar Berat Rukiqin për pozitën e re, duke thënë se Oda Ekonomike ka qenë zë i fuqishëm i mbrojtjes së interesave të bizneseve në Kosovë. Ai ka thënë se edhe pse me zero buxhet të ndarë nga Qeveria e Kosovës, ata e kanë dhënë maksimumin për ngritjen e zërit në interes të bizneseve në Kosovë. "Oda

Ekonomike e Kosovës ka zero buxhet dhe paramendoni sa lobimi është bërë për promovim të bizneseve dhe përmirësim të imazhit të Kosovës, kurse ministrët e tjera kanë miliona euro dhe nga kjo mund ta bëjmë dallimin", është shprehur Gërxhaliu, i cili, me rastin e dorëzimit të detyrës, ia ka dërguar kryetarit të sapozgjedhur edhe pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit, duke i uruar ta vazhdojë misionin e Odës Ekonomike.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka vlerësuar se pranim-dorëzimi i detyrës në këtë mënyrë është model edhe për institucionet e tjera. "Pranim-dorëzimi i detyrës në mënyrë solemne është shembull që duhet të



ndiqet edhe nga të tjerët. Oda ka traditë 55-vjeçare dhe ne do ta vazhdojmë traditën", është

shprehur Rukiqi. Ai ka thënë se si kryetar i OEK-ut ka mision tri objektiva kryesore. "Në man-

datin tim do të angazhohem për rritje të eksporteve të Kosovës që do të gjenerojë vende të reja të punës. Harmonizim në mes të sistemit arsimor dhe praktikës, si dhe ekonomi digjitale", është shprehur Rukiqi.

Berat Rukiqi është zgjedhur kryetar i OEK-ut me mandat katërvjeçar. Përveç kryetarit, kuvendi i ri i OEK-ut ka 71 anëtarë i cili zgjodhi edhe Këshillin e Ri Drejtues me përbërje nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë. Po ashtu, është zgjedhur edhe Këshilli Mbikëqyrës si dhe sekretari i përgjithshëm Parim Bajrami. Të gjitha strukturat drejtuese të Odës Ekonomike të Kosovës janë zgjedhur për mandat katërvjeçar.



# Thaçi: Prodhimet 'Made in Kosova', pjesë e tregjeve evropiane dhe botërore



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vizituar të enjten fabrikën për prodhimin e produkteve të ambalazhimit "Kivo" në Kaçanik. Ai ka thënë se kjo fabrikë është dëshmia më e mirë se produktet "Made in Kosova" çdo ditë e më shumë po eksportohen në tregun evropian

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

**KAÇANIK, 12 KORRIK** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, të enjten ka vizituar fabrikën "Kivo" në Kaçanik, një investim ky kosovar-holandez, me mbi 110 të punësuar. Presidenti Thaçi ka

thënë se kjo fabrikë është dëshmia më e mirë se produktet "Made in Kosova" çdo ditë e më shumë po eksportohen në tregun evropian. "Unë kam besim se modeli i tillë, çfarë e kemi këtu në 'Kivo', është modeli më i mirë i mundshëm për biznesin privat, për bashkëpunimet vendore dhe ndërkombëtare, për klimën e mirë të biznesit në Republikën e

Kosovës, për fuqinë punëtore, atraktivitetin e të investuarit në Kosovë, por edhe dëshmi se, pavarësisht prej vështirësive që i kemi si shtet, prodhimet 'Made in Kosova' sot janë kudo, janë në Holandë, në Gjermani, në Francë, në shtetet më të rëndësishme evropiane e më gjerë", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se kjo mundësi e krijuar nga pronarët e fabrikës "Kivo" është një perspektivë e mirë për Kaçanikun dhe një mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës. "Me të vërtetë është një perspektivë shumë e mirë edhe për Kaçanikun, për njerëzit e Kaçanikut, për krijimin

e vendeve të reja të punës, për punësimin e tyre të mëtutjeshëm, për rritjen e mirëqenies sociale të familjeve të tyre, por edhe mundësi tjetër e një ekspertize për zgjerim edhe në hapësirat e tjera të Republikës së Kosovës", ka shtuar presidenti Thaçi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se kjo është një kompani shembull për të tjerët. "Besoj dhe shpresoj se me përvojën dhe ndikimin që kanë pasur pronarët e kësaj kompanie, kanë bërë një diçka jashtëzakonisht të mirë që, në fakt, kemi pasur edhe interesime të tjera në Komunën e Kaçanikut", ka thënë kryetari Ilazi.

Pronari i fabrikës "Kivo", Visar Ramajli, ka thënë se kompania merret me prodhimin e produkteve të ambalazhimit fleksibil. "Është një bashkinvestim në mes të investitorëve lokalë dhe atyre holandezë, si dhe ka katër vjet që operon dhe suksesshëm eksporton në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian", ka thënë Ramajli.

Presidenti Thaçi në fund ka thënë se institucionet e vendit janë përkrahë ndërmarrësve, aq sa kanë mundësi, t'i lehtësojnë angazhimet për hapjen e mundësive të reja për biznes, për vende të punës dhe për mirëqenie më të mirë sociale.

## Policia e Dogana zotohen për luftimin e ekonomisë joformale

**PRISHTINË, 13 KORRIK (ER)** - Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, ka pritur të enjten në takim drejtorin e përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, me të cilin ka biseduar për ngritjen dhe avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, luftimin e

ekonomisë joformale, luftimin e kontrabandës si dhe bashkërendimin e aktiviteteve në pikat doganore. Qëllimi i avancimit të bashkërendimit të aktiviteteve në pikat doganore është që të ndihmojë në lehtësimin e qarkullimit dhe lëvizjes së bashkatdhetarëve që vijnë në pushime në vendin

tonë gjatë sezonit veror. Rexha ka falënderuar Berishën, duke vlerësuar se vizitat ndërinstitucionale do të shërbejnë për ta forcuar bashkëpunimin reciprok në të mirë të qytetarëve. Rexha e Berisha janë zotuar për vazhdimin dhe ngritjen e mëtejme të bashkëpunimit të ndërsjellët edhe në të ardhmen.



# Shoqëritë e robëruara në kushte lirie mund ta robërojnë veten

Ymer BERISHA

Jetëgjatësia e sundimit të të huajve në trojet dhe shoqërinë tonë po rezultojnë me pasoja fatale në ndërtimin e shtetit, konsolidimin institucional e ligjor, meritokracinë, vendimmarrjen demokratike dhe konkurrencën e barabartë për të gjithë.

Vlera më sublime e njeriut (individit), parë në të gjitha teoritë, vazhdon të mbetet formimi i tij intelektual e kulturor, gatishmëria për t'i ndihmuar proceset e zhvillimit të shoqërisë, në përgjithësi deri te gatishmëria për sakrificë me jetë, për çështje kombëtare apo edhe për kauzat e drejta humane planetare.

Liria jonë, dinjiteti i përgjithshëm shoqëror e shtetëror yni, erdhin falë luftës çlirimtare dhe sakrificave të papara në shekujt e fundit në shoqëritë e tjera për lirinë e tyre, flijime të përmasave që nuk njih historia e luftërave, u flijua njeriu ynë i porsalindur edhe ai

mbi një shekull jetë, qëndresë dhe përballje me tokën e djegur, shuarjen e jetës, jo vetëm për ne: edhe bimët e shtazët u munduan t'i vrasin në këto hapësira. E ne qëndruam krenarë për lirinë tonë, shtetin dhe integritet në shoqërinë evropiane, aty ku edhe na ka falë Zoti.

Paslufta për elitat shoqërore, politike, për shoqërinë në përgjithësi, po rezultojnë shumë sfiduese. Humbëm qartësinë e qëllimeve tona kombëtare, dëmtuam rëndë mundësinë për jetë më kualitative, humbëm besimin në gjithçka, madje po rrezikojmë shumë edhe rrënimin e vlerave shoqërore, etike, tradicionale, kombëtare e shtetformuese që i kishim.

Bota akademike e Kosovës dhe profesorët, duke vlerësuar kaluesë dijen e nevojshme për gradë profesionale, fakultative, të masterit, në raste edhe doktoratën, jo kujdesshëm e ngopën konkurrencën me diploma letrë duke u shndërruar në "shoqëri

akademike, shkencore, me mundësi të avancuara për tregun institucional e politik të punës". Për dy dekada jetë lirie, të gjithë u bëmë me diploma fakulteti, të gjithë u bëmë elitare për asgjë, sepse lejuam të blihet - korruptohet dija.

Politika dhe institucionet u pushuan nga njeriu i familjes së madhe, të fortë, me dije të korruptuar (blerë) ose anëtar servil politik i partive-shtet dhe gradualisht devijuam vendimmarrjen institucionale, atë politike, punën administrative, arsimin dhe gjithë sektorët e tjerë të jetës, madje devijuam edhe cilësinë e saj si pasojë e mungesës së kompetencës profesionale, pa përgjegjësi morale e ligjore, si pasojë e pseudo njerëzve me diplomë.

Kuvendi i shtetit tonë si institucioni më i lartë përfaqësues në dy dekada liri, degradoi në arenë gladiatorësh, njerëzve me muskuj, arenë e fjalorit primitiv banal, në raste të caktuara burim

rreziku edhe fizik, me vendimmarrje jo përfaqësuese, jo cilësore, që nuk rregullon dhe funksionalizon asnjë sektor të jetës, me gjasë të rrëshqasim drejt një shoqërie të çorganizuar dhe pa besim.

Përfaqësimi qytetar në kuvend, vetëm postulat deklarativ fiktiv. Gjatë dy dekadave liri edhe mund të kemi humbur territor të shtetit, shtetit të dëshmorëve të kombit.

Qeveria e shtetit, mjerisht në masë të madhe pa kredibilitet politik, pa vizion e ide për zgjidhjen e çështjeve dhe nevojave qytetare, me kuadër human në nivel ministrash pa asnjë ekspertizë të fushës, njerëz që punë të parë intelektuale, në jetën e tyre e kanë pozitën e ministrit. Rezultatet më shumë po krijojnë probleme sesa po zgjidhin ato. E zëvendësministrat janë, mjerimi i pozitave publike shtetërore.

Shoqëria jonë ka nevojë që secili nga ne, në vetën e parë, nga kryetari i shtetit deri te lopari në

fshat, të reflektojmë për punën që bëjmë, angazhimet publike e politike, përgjegjësitë morale e ligjore që kemi ndaj fëmijëve, familjes dhe shtetit, me urgjencë t'i korrektojmë veprimet dhe vendimmarrjen me standardin e nderit, ndryshe rrezikojmë ta humbim mundësinë e shtetit funksional dhe vendit ku mund të konkurrojmë barabartë të gjithë, ta duam më shumë shtetin sa dëshmorët e kombit atdheun dhe t'ua sigurojmë të ardhmen e ndritur fëmijëve.

Të heqim dorë me patjetër nga dija e blerë, nga pozitat publike ku jemi jokompetentë, t'i themi jo sindromës së varfërisë për gjithçka, t'i kthehemi vetes tonë, familjes e Kosovës, ngaqë të tyre jemi dhe ndaj tyre kemi obligime e përgjegjësi. Ndryshe jemi të humbur të gjithë, pasojë e të gjithëve nga pak. Pastaj elita politike që po vendos për ne, le të ndihet "krenare" që vrau mundësinë dhe të nesërmen tonë.



## KE-ja financon themelimin e Institutit për Inovacion dhe Punësim në UPZ

Prizren, 12 korrik (ER) - Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. dr. Ramë Vataj, ka nënshkruar marrëveshjet e grantit për projektin "Krijimi i qendrave nga teoria në praktikë për inovacion dhe punësim", financuar nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian,

me prof. Mihone Kerolli Mustafa, përfaqësuese zyrtare e këtij grant. Qëllimi i grantit është themelimi i Institutit nga Teoria në Praktikë për Inovacion dhe Punësim në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.

Rektori Vataj e ka vlerësuar lart

nënshkrimin e këtij granti, duke theksuar se është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të UPZ-së. Ky projekt paraqet shumë mundësi për të gjithë stafin e studentët e institucioneve partnere dhe më shumë. Vlera e përgjithshme e këtij granti është 1.164.002,00 euro.

## Kryetari Latifi vizitoi Kooperativën Bujqësore 'Krusha'

Rahovec, 12 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka vizituar Kooperativën Bujqësore "Krusha" në fshatin Krushë e Madhe ku është pritur nga Fahrije Hoti, drejtoreshë e Kooperativës. Gjatë takimit kryetari Latifi ka biseduar me drejtoreshën Hoti për ecurinë e punëve dhe planet e tyre që kanë për kooperativën. Latifi e ka inkurajuar drejtoreshën Hoti dhe stafin e saj të vazhdojnë të kontribuojnë për të mirën e familjeve të tyre, prodhuesve krushjanë dhe për të mirën e vendit në përgjithësi. Gjithashtu, Latifi rikonfirmoi qëndrimin për përkrahje dhe partneritet konkret ndaj bizneseve prodhuese. Ndërsa Fahrije Hoti, drejtoreshë e Kooperativës Bujqësore "Krusha", fillimisht e ka falënderuar kryetarin

Latifi dhe stafin e tij për vizitën. Ajo ka thënë se ende ka nevojë për mbështetje institucionale dhe financiare në mënyrë që të kenë kushte edhe më të mira për punë.

Kooperative Bujqësore "Krusha" merret me konservimin e specave turshi të 12 llojeve të ndryshme dhe të ajvarit shtëpiak. Të gjitha prodhimet e kësaj kooperative janë tradicionale dhe recetat që përdoren për këto produkte janë shtëpiake, për këtë arsye prodhimet e kësaj kooperative shikohen si prodhime të vlefshme në krahasim me ato industriale.



## Bahtiri ofron përkrahje për Bashkësinë Islame të Mitrovicës

Mitrovicë, 12 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur kryetarin e Bashkësisë Islame (BI) të Mitrovicës, Irfan Krasniqi, me bashkëpunëtorë, me të cilët ka biseduar për çështje me interes të

përbashkët dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit.

Kryetari Bahtiri u ka thënë përfaqësuesve të BI-së të Mitrovicës se ai dhe komuna gjithmonë kanë qenë për bashkëpunim të mirë me BI-në dhe kështu do të

vazhdojnë edhe në të ardhmen. Bahtiri u ka thënë drejtuesve të BI-së se i mbështet kërkesat e tyre për ndërtimin e xhamisë në cepin verior të komunës. "Besoj se kjo çështje do të adresohet dhe fillon të zgjidhet shumë shpejt",

ka thënë Bahtiri. Ai ka thënë se përkujdesja për varrimin e të vdekurve do të jetë obligim i BI-së, ndërsa komuna do të paguajë për shërbimet që ajo i kryen sipas marrëveshjes që ka qenë deri më tani.





## Pompeo: Evropa të ketë një qëndrim të ashpër ndaj Iranit

**BRUKSEL, 12 KORRIK** - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, u bëri thirrje vendeve evropiane të mbajnë një qëndrim të ashpër ndaj Iranit, duke shkurtuar të gjitha fondet që vendi mund të përdorë për të nxitur paqëndrueshmëri në Lindjen e Mesme dhe më gjerë.

Pompeo u takua me zyrtarët evropianë në Bruksel, pas takimit të udhëheqësve të NATO-s. Ai u kërkoi atyre të bashkohen me një fushatë presioni ekonomik të udhëhequr nga ShBA-ja kundër Teheranit, që nisi pasi presidenti

Donald Trump u tërhoq nga marrëveshja e rëndësishme bërthamore e Iranit në muajin maj. "Ne u kërkujmë aleatëve dhe partnerëve tanë të bashkohen me fushatën tonë të presionit ekonomik ndaj regjimit të Iranit", ka shkruar Pompeo në një postim në "Twitter" përpara bisedimeve. "Ne duhet t'i presim të gjitha fondet që regjimi përdor për ta financuar terrorizmin dhe luftërat e ndërsjella. Do të jetë e pamundur të përcaktohet se kur Irani mund të përpiqet të nxisë terrorizmin, dhunën dhe paqën-

drueshmërinë në një nga vendet tona më pas", tha ai. Postimi i tij shoqërohej me një hartë që akuzonte Iranin për sponsorizimin e të paktën 11 sulmeve terroriste në Evropë që nga viti 1978.

Komentet e Pompeo vijnë pasi zyrtarë të tjerë amerikanë po zhvillojnë vizita në vende të ndryshme të botës për t'i paralajmëruar ato ta ndalojnë blerjen e naftës nga Irani, në të kundërtën do të përballen me sanksione dhe pasi ai akuzoi Iranin për përdorimin e ambasadeve të saj për të komplotuar sulme terroriste në Evropë.



# Trumpi mbërrin në Londër, nis vizitën në Britani

Pas arritjes për vizitë zyrtare në Londër të enjten, presidenti amerikan Donald Trump pritet të takohet me kryeministren Theresa May, e cila kërkon një marrëveshje tregtare për periudhën "post-Brexit". Mbërritja e tij në Londër është shoqëruar me masa shtesë sigurie



**LONDËR, 12 KORRIK** - Presidenti amerikan Donald Trump të enjten ka shkelur tokën britanike në Londër, me fjalët se ndihet "komod" me protestat e mundshme që do të zhvillohen gjatë vizitës së tij, duke shtuar se britanikët "e pëlqejnë shumë atë". Duke folur më herët gjatë Samitit të NATO-s, Trumpi, i cili mbërriti në ishull të enjten në orët e pasdites, iu referua Britanisë si një "hot spot" tejet i nxehtë. Ai pritet të takohet me kryeministren Theresa May më vonë, me këtë të fundit që kërkon një marrëveshje tregtare për periudhën "post-Brexit", vetëm pak ditë pasi ai deklaroi se Britania gjendet në mesin e trazirave. Sigurisht, mbërritja e tij në Londër është shoqëruar me masa shtesë sigurie, për më tepër që duhet të monitorohet dhe të sigurohet mbarëvajtja e disa protestave të planifikuara që do të shoqërojnë vizitën e tij.

Trumpi do të takohet edhe me

mbretëreshën Elisabeth II gjatë vizitës dyditore të punës. "Mendoj se më pëlqejnë shumë këtu në Britani, për më tepër mendoj se ata pajtohen me mua sa i përket emigracionit. Ju po e shihni se ç'po ndodh anembanë botës me emigracionin. Mendoj se kjo është arsyeja pse ndodhi edhe Brexit", tha presidenti Trump. Ai u shpreh se populli britanik "votoi për t'u shkëputur, kështu që kjo është edhe ajo që pres të ndodhë", teksa theksoi me ton tjetër faktin se "Brexit është Brexit".

Trumpi është vënë në qendër të kritikave kohët e fundit për shkak të politikës së tij për emigracionin, që rezultoi me ndarjen e fëmijëve nga familjarët e tjerë që hynin në mënyrë të paligjshme në ShBA. Ndërkaq në Bruksel ai tha se ka siguruar angazhimet e anëtarëve të NATO-s për t'i rritur shpenzimet e tyre të mbrojtjes, pasi për ditë me radhë udhëheqësi amerikan kishte thënë se Uashingtoni po mbante një barrë të tepruar të mbështetjes financiare të aleancës. "Ata kanë rritur në mënyrë të kon-

siderueshme angazhimin e tyre për mbështetjen financiare dhe ne jemi shumë, shumë të kënaqur dhe kemi një NATO shumë, shumë të fuqishme", u tha Trumpi gazetarëve në mbyllje të takimit të aleancës në Bruksel.

Ai nuk tha konkretisht se cilat vende ishin angazhuar dhe për çfarë shume. "Disa janë në nivelin e angazhimit për dy për qind të prodhimit të brendshëm bruto dhe të tjerë janë pajtuar të arrijnë në nivelin dy për qind. Një ditë më parë Trumpi kishte

sugjeruar që aleatët e NATO-s të premtonin ta rrisnin deri në katër për qind kontributin e tyre të mbrojtjes deri në vitin 2024. "Unë kam besim te NATO", tha Trumpi në një konferencë me gazetarë, por shtoi se Shtetet e Bashkuara po trajtohen shumë padrejtësisht, duke mbështetur financiarisht aleancën ushtarake shtatëdhjetëvjeçare, duke këmbëngulur se Uashingtoni po mbante barrën e shpenzimeve në masën 70 deri në 90 për qind, që ai tha se nuk ishte e drejtë për taksapaguesit amerikanë.

## Khan: Protestat kundër Trumpit duhet të jenë paqësore

**LONDËR, 12 KORRIK** - Protestat në Londër kundër vizitës së presidentit amerikan Donald Trump duhet të jenë "paqësore", ka thënë të enjten kryetari i Londrës, Sadiq Khan, pasi lideri amerikan ka arritur në kryeqytetin britanik, transmeton "Reuters". "Mesazhi

im për ata që protestojnë në Londër është që ato duhet të jenë paqësore. Ata që kanë qëllim shkaktimin e problemeve dhe shkeljen e ligjit, unë u them se nuk janë të mirëseardhur", ka thënë ai përmes një deklaratë. Khan, anëtar i Partisë Laburiste,

që aktualisht është në opozitë, më herët ka pasur përplasje me Trumpin, duke thënë se protestat kundër tij nuk janë kundër Amerikës dhe në vend të saj banorët e Londrës kanë treguar pakënaqësitë e tyre për politikën e "frikës dhe dëshpërimit".



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVIÇA – BASIC COURT OF MITROVIÇA

GJYKATA THEMELORE  
C.nr.73/2011  
Me dt. 22.06.2018  
Mitrovicë

Te perditshmes informative

**PRISHTINË**

Ne bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkohet të publikoni këtë,

**SH P A L L J E**

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit Aziz Hajra nga Mitrovica kundër të paditurve: Masar Berani, Tahir Berani, Ferat Berani, Shaip Berani, Nuhi Berani, Hixhirije Berani nga Mitrovica, tani me vendbanim të panjohur, në bazë të nenit 79 pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës të paditës Hixhirije Berani i caktohet përfaqësuesi i perkohshëm – Avokati Valon Mehmeti Osman Haliti nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i perkohshëm do ta përfaqësojë të paditurin në këtë çështje juridike deri sa ajo apo i autorizuar i saj të paraqitet në këtë gjykatë.

GJYQTARI  
Ragip Kadriu

*Shijo Pranverën me...*

**Jaffa**  
Champion PLUS  
**A+C+E**  
Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

**Jaffa**  
Champion

E rrallë

## Breshka që "refuzon" të largohet nga Shqipëria

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka njoftuar se breshka detare e llojit "Kareta Kareta", e gjetur dy javë më parë në Kune Vain, u dërgua në Vlorë për mjekim. Pasi iu dha ndihma mjekësore nga mjeku veteriner dhe u lëshua në det,



a jo u kthye përsëri në pikën ku u lëshua. Kjo breshkë ka gjatësi 69 cm, gjerësi 64 cm, peshë 45 kg dhe është femër.

## BARSOLETA E DITËS



Zotërinj, komandanti i aeroplanit ju paralajmëron se avioni po rrëzohet, dhe u lutet zotërinjve pasagjerë t'i mbajnë pasaportat me dhembë, duke evituar kaosin e zakonshëm që ndodh për njohjen e kufomave.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit  
në ora 16:00

## "INCREDIBLES 2" 3D


I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



## FOTO E DITES



Artisti francez Abraham Poincheval vesh një uniformë të blinduar. /AFP/


Në ora 18:20

## "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

## "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

## "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

## E jashtëzakonshme

## Djali i vdekur "luan" "PlayStation" në funeralin e vet

Familja e Renard Matthews, e një djaloshi nga New Orleans i cili vdiq në një shkëmbim zjarri me policinë, ia kanë dhënë lumturën e fundit në një mënyrë të pazakontë. Në fakt, trupi i të riut ishte i ulur në një karrige dhe i



veshur me një T-shirt të Boston Celticsit (me të cilët Matthews ishte tifoz), por gjithashtu djali mbante në duar një levë "PlayStation" për ta dëshmuar pasionin e madh për videolojërat.



### DASHI

Nuk është se keni arritur të zgjidhni


çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



### DEMI

Keni fituar pavarësi morale dhe financiare

nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



### BINJAKËT

Një detaj që po ju ha shumë kohë dhe po

ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni perfeksionist dhe do t'ia arrini qëllimit.



### GAFORRJA

Keni filluar të keni më shumë

besim tek personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



### LUANI

Nuk keni shumë kohë për mëdyshje

dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



### VIRJËRESHA

Keni zgjedhur mënyrën më të

thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



### PESHORJA

Komunikimi është shumë i rëndësishëm

sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



### AKREPI

Një person ka krijuar një ide të gabuar për ju

që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni mund ta ftoni për një takim.



### SHIGJETARI

Keni vënë baza të forta për të ardhmen tuaj

profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



### BRICJAPI

Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes sot

që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që, dashur-padashur, i kushtëzon edhe ata.



### UJORI

Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse ta

merreni në dorë situatën dhe t'i mundoheni të zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



### PESHQIT

Keni qenë shumë të ndjeshëm ndaj

ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.

## Beyonce shtatzënë?



**A**jo është afër përfundimit të turneut të saj me Jay Z, me 18 koncerte nëpër Evropë. Beyonce dukej tejet e relaksuar përdherisa kishte dalë për drekë në Kanë të Francës, e shoqëruar nga


Jay Z dhe vajza e tyre Blue Ivy. 36-vjeçarja dukej fantastike në një fustan përplot lule, i cili ishte i gjerë dhe i kishte mbuluar barkun, duke shtuar dyshimet për shtatzëni.

## Kylie dhe Travis me të bijën në Hawaii



**K**ylie Jenner dhe Travis Scott kanë nisur pushimet në Honolulu në Hawaii. Sipas "TMZ", çifti ka marrë me qira një vilë të pajisur me lodrat e preferuara të

vajzës së tyre Stormi si dhe një studio të incizimit. Kjo familje shijoi disa ditë të bukura në plazhet private, ndërsa Travis tashmë ka vazhduar punën për albumin e ri.




## Kylie Jenner, më e pasur se motra e saj Kim Kardashian

**K**ylie Jenner ka linjën make up më të famshme në botë dhe sigurisht se edhe të ardhurat janë shumë të mëdha. E vogla e klanit Kardashian, Jenner, ka tashmë një markave më në zë dhe kjo

i ka sjellë 20-vjeçares shuma të mëdha. Sipas "Forbes", Kylie Jenner është më e pasur se motra e saj e famshme Kim Kardashian. Pasuria e Kylie llogaritet të jetë rreth 900 milionë dollarë.

## Vrasja e reperit, arrestohet i dyshuari i dytë



**N**jë person tjetër është arrestuar për vrasjen e reperit XXXTentacion. Michael Boatwright, 22 vjeç, u arrestua më 5 korrik për drogë dhe më 10 korrik u akuzua për vrasje të shkallës së parë.

Boatwright ndodhej në paraburgim kur policia e akuzoi për vrasjen e reperit në Florida muajin e kaluar. XXXTentacion, emri i vërtetë i të cilit është Jahseh Onfroy, u qëllua më 18 qershor dhe vdiq në spital.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**sport**

**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

VEJLE - HOBRO

1

FINN HARPS - LONGFORD

1

SHELBOURNE - DROGHEDA UTD

3+

# Prishtina mund të kualifikohet, Drita e papërvojë për Malmon



Genc Sermaxhaj ka thënë për "Epokën e re" se Prishtina nuk luajti mirë në ndeshjen e parë, por ka shanse të mira për të eliminuar CS Fola Elsç, kurse për përballjen Drita - Malmo beson se dallimi është i madh në favor të Suedisë

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 12 KORRIK** - Kampionia e Kosovës në Futboll, Drita dhe fituesja e Kupës, Prishtina, i kanë zhvilluar ndeshjet e radhës në garat ndërkombëtare. Drita ka pësuar humbje nga Malmo në ndeshjen e parë 0-3, kurse Prishtina i ka nxjerrë barazim CS Fola Elsç (0-0). Ish-futbollisti i këtyre dy skuadrave dhe tash analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se skuadrat e Kosovës patën kundërshtarë të ndryshëm për nga cilësia, prandaj edhe rezultatet e arritura janë dëshmi e kësaj. "Ne gjithnjë duhet t'i vlerësojmë drejt dhe profesionalisht paraqitjet e

ekipeve tona në kampionatin vendor apo në garat evropiane. Kritikë apo lëvdatat që ne bëjmë duhet të merren parasysh nga udhëheqësit e klubeve. Drita dhe Prishtina kanë pasur kundërshtarë të ndryshëm dhe jo të nivelit të njëjtë", ka thënë fillimisht Sermaxhaj. Ish-mesfushori me cilësi të larta në futbollin e Kosovës, duke folur për ndeshjen e zhvilluar në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" në mes të Dritës dhe Malmos, ka thënë se skuadra suedeze dëshmoi se kishte përvojë më të madhe se Drita. "Malmo tregoi se është ekip më shumë përvojë, kurse Dritës i mungoi përvoja në gara të tilla, cilësia e futbollistëve kundrejt Malmos me përvojë, futbollistë me

efikasitet para portës. Ata iu lejuan hapësira futbollistëve të Dritës, më pas me tri pasime realizonin gola. Kjo bëri edhe dallimin në atë ndeshje", ka deklaruar ai. Sermaxhaj ka shprehur optimizëm se Prishtina në ndeshjen e dytë mund ta mposhtë skuadrën nga Luksemburgu. "Fola është një ekip jo shumë i nivelit të lartë, por afërsisht i barabartë me Prishtinën. Në ndeshjen e dytë, Prishtina ka mundësi ta fitojë ndeshjen ndaj kësaj skuadre, por mënyra se si luajti Prishtina nuk ishte bindëse dhe kreative. Në përgjithësi ishte ndeshje e nivelit të dobët, ku të dyja ekipeve u mungonte cilësia në fazën e sulmit, në pasimet e fundit dhe konkretizimin e rasteve", ka deklaruar Sermaxhaj.

## SHKURT

### Ademi: Prishtina do ta eliminojë CS Fola Elsç

Kryetari i ri i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka uruar Prishtinën për barazimin e arritur si mysafire e skuadrës nga Luksemburgu, CS Fola Elsç (0-0). Ai ka shprehur optimizëm se kryeqytetasit në ndeshjen e dytë do ta sigurojnë kualifikimin. "Barazimi i FC Prishtina kundër CS Fola Elsç edhe një herë dëshmoi se futbollit ynë po ecën me hapa të sigurt përpara. Uroj të gjithë stafin e klubit dhe tifozët për këtë rezultat, me shpresën dhe besimin se në ndeshjen e kthimit pas një jave, FC Prishtina, me përkrahjen e tifozëve, do të arrijë të shënojë fitore dhe do ta kalojë rrethin e parë kualifikues të Ligës së Evropës, që do të ishte një tjetër sukses për futbollin e Kosovës. Urime e paçi fat!", ka thënë Ademi.

### Kjo është paga e trajnerit të Kroacisë

Kroacia ka arritur një sukses historik duke u kualifikuar për herë të parë në finale të Kupës së Botës, por ajo që bie në sy është paga jo e lartë e trajnerit Zlatko Dalij. Trajneri në fjalë është i 22-ti në këtë pikë ndër 32 trajnerët e evenimentit me një pagë 550 mijë euro që është sa 1/4 e asaj të Southgate dhe shtatë herë më e ulët se paga e trajnerit të Francës, Didier Deschamps.

### Chelsea shkarkon Conten

Skuadra e Chelseat e ka shkarkuar Antonio Conten nga detyra e trajnerit. Në edicionin e parë, Conte arriti ta fitojë titullin me skuadrën e Chelseat, kurse në edicionin e dytë ishte larg objektivat e klubit. Italiani Maurizio Sarri pritet t'i prijë Chelseat në edicionin 2018/2019, kurse Conte do të fitojë 9 milionë euro nga ky shkarkim.

### Pedrosa njofton pensionimin nga MotoGP

Piloti i Hondës, Dani Pedrosa, ka bërë me dije se ky është sezoni i tij i fundit në MotoGP. "Është një vendim i vështirë pasi bëhet fjalë për sportin që dua, por nuk e përjetoj më konkurrencën si më parë dhe tani kam të tjera prioritete", ka thënë 32-vjeçari Dani Pedrosa.

### Juve, pas Ronaldos, e dëshiron edhe Marcelon

Kampionia e Italisë në futboll, Juventus, pasi arriti marrëveshje për transferimin e Cristiano Ronaldos po synon të rrëmbejë edhe një tjetër lojtar nga Real Madridi. Mediet italiane kanë raportuar se interesimi i "Zonjës së Vjetër" është braziliani Marcelo, i cili ka raporte të shkëlqyera me Ronaldon. Ndërsa Alex Sandro mund të largohet nga Juventusi për të kaluar në Manchester United.

## Rusia uron FFK-në për kryetarin e ri, habitet Serbia

**PRISHTINË, 12 KORRIK** - Federatë e Futbollit e Rusisë e ka uruar Federatën e Futbollit të Kosovës për zgjedhjen e kryetarit të ri, Agim Ademit. Me këtë urim ka

mbetur e habitur Serbia. "Këtë pakkush e ka pritur në Serbi", përcjellin mediet serbe. Federata ruse uroi kryetarin e ri, Ademin, pas zgjedhjes së tij në postin e

presidentit të ri të FFK-së. "I gëzohemi bashkëpunimit të federatave tona dhe ju dëshirojmë juve dhe federatës suaj prosperitet dhe shumë suksese.

Gjithmonë mund të llogarisni në përkrahjen tonë për të gjitha çështjet e futbollit", thuhej në urimin e Rusisë. "Shpresoj që së shpejti do të takohemi gjatë

ngjarjeve të ndryshme futbollistike", është teksti i urimit që e ka nënshkruar sekretari i përgjithshëm i Federatës ruse, Aleksandr Alaeu.



## Bekaj: Kualifikimin e sigurojmë në Mitrovicë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Portieri Visar Bekaj është i bindur se FC Prishtina kualifikimin do ta sigurojë në Mitrovicë. Ndeshja e parë në Luksemburg në mes të Folas

dhe Prishtinës përfundoi me rezultat 0-0. "Besoj se u ndamë mirë edhe pse kemi mundur t'i shfrytëzonim disa raste në fund që na u dha mundësia. E them që ishte

ndeshje e mirë, të dyja skuadrat luajtën kujdesshëm, duke tentuar ta ruanin portën pa pranuar gol, pastaj të bënin diçka më shumë përpara. Jam i kënaqur, është

rezultat i kënaqshëm dhe shpresoj se në Mitrovicë do ta kalojmë raundin, sepse na duhet fitorja gjithqysh", ka thënë Bekaj për faqen zyrtare të Prishtinës.



## Kozniku: E lus Zotin që Kroacia t'i hakmerret Francës

ZAGREB, 12 KORRIK - Kroacia ka shkruar historinë për vendin e vet për shkak të kualifikimit për në finale të Botërorit për herë të parë. Kroacia do të ndeshet me Francën në finalen e madhe të Kampionatit Botëror dhe nëse arrin ta fitojë Botërorin, do të jetë ekipi i parë nga Ballkani që triumfon në kompeticionin më të madh në botë.

Ardian Kozniku, i cili ishte reprezentues i Kroacisë në Botërorin e vitit 1998, njëherësh edhe futbollisti i parë shqiptar që ka marrë pjesë në Kupën e Botës, ka dhënë një intervistë para ndeshjes finale në mes të Kroacisë dhe Francës. "Në tërë Kroacinë ka mbretëruar dhe po mbretëron festë e madhe, pas triumfit ndaj Anglisë në gjysmëfinale të Kupës së Botës në Rusi. Kjo fitore është festuar në të gjitha qytetet kroate, kanë festuar i madh e i vogël. Kjo gjeneratë nuk na e kaloi vetëm neve që fituam vendin e tretë në Botërorin e Francës në vitin 1998, por edhe gjithë botës", ka thënë Kozniku në një intervistë për "Lajm". "Një shtet me vetëm katër milionë banorë të luajë në finale, kjo është diçka fantastike. Ende nuk na besohet se jemi në finale të Botërorit. E tash kemi një tjetër ëndërr, ta fitojmë trofeun e Kupës së Botës. Më vjen mirë që kësaj feste i janë bashkuar jo vetëm shqiptarët që jetojnë në Kroaci,



por edhe në Kosovë dhe Maqedoni. Finalja shpresoj të jetë një lojë e mirë, sepse aty kanë mbërritur skuadrat më të mira dhe me plot meritë. Franca ka lojtarë fantastikë, por mos harroni se edhe Kroacia ka lojtarë fantastikë. Të dyja kombëtarët kanë top emra. Mendoj se shanset janë 50-50, por normalisht se kam dëshirë

të fitojë Kroacia. E lus Zotin që këta lojtarë t'i revanshohen Francës për atë humbjen e vitit 1998. Loja mund të zgjasë edhe 120 minuta, nuk i dihet, sepse është finale e Botërorit, por shpresoj se me lojë të mirë dhe me pak fat, mund ta fitojmë Kupën e Botës", ka përfunduar Ardian Kozniku.

## Magic Johnson: Ja si e binda LeBron Jamesin të vijë te Lakersi

LOS ANXHELOS, 12 KORRIK - "Takimin me LeBron Jamesin e kishim lënë në orën 21:01, por vajta një orë më herët. Ky ishte takimi im më i rëndësishëm si drejtues i Lakersit dhe nuk doja të dështoja, pasi kisha muaj që përgatitesha për këtë takim me LeBron Jamesin", ka thënë Magic Johnsoni, një legjendë e NBA-s dhe e Lakersave, tashmë në postin e drejtorit sportiv të ekipit kalifornian.

Takimi është zhvilluar në zonën e Brentwood, në Los Anxhelos, pak metra larg shtëpisë që "King James" ka në këtë qytet. "Kam qëndruar në makinë derisa erdhi ora dhe më pas i tregova për gjithçka që donte të dinte", ka deklaruar Johnson. "Që në momentin që hyra në derën e shtëpisë së LeBron pati një sintoni mes nesh. Jemi të ngjashëm, pasi jemi rritur në var-



fëri, të dyve na pëlqen të fitojmë dhe kemi treguar një basketboll në nivele të jashtëzakonshëm. LeBron është një nga basketbollistët më inteligjent që kam takuar, si Kobe, Michael Jordan apo Larry Bird. Ai e njihnte skuadrën e Lakersit më mirë se unë. E analizoi 'një për

një' skuadrën dhe më konfirmoi se i pëlqen stili i lojës së trajnerit Luke Walton. Nuk folëm për kontratën, pasi LeBron më kishte ftuar të flisnim për ekipin. Më pas i thashë edhe për blerjet e tjera që do të bënim dhe pranoi të vinte", ka shtuar Magic.

### SHKURT

#### Modriqi: Teknikisht dhe fizikisht ishim më të mirë se Anglia

Luka Modriqi është i bindur se Kroacia e meritoi kualifikimin në finale pasi ishte më e mirë se Anglia teknikisht dhe fizikisht. "Mendoj se e meritojmë të jemi në finale. Kemi qenë shumë më mirë teknikisht dhe fizikisht se Anglia".

#### Liverpooli, 65 milionë për portierin e Romës

Liverpooli një vit pas transferimit të Mohamed Salahit nga Roma po synon të bëjë të njëjtin gjë edhe me portierin Alisson. "La Gazzetta dello Sport" raporton se skuadra angleze është gati të ofrojë 60 milionë, plus 5 milionë bonuse për portierin brazilian, i cili kërkohet edhe nga Real Madridi. Roma për portierin e saj të parë kërkon 70 milionë euro.

#### Unitedi e kërkon Balen


Pas largimit të Cristiano Ronaldos te Juventus, Manchester Unitedi i ka hedhur sytë kah ylli tjetër i ekipit madrilen, Gareth Bale. Uellsiani po kërkohet edhe më parë nga "djajtë e kuq", por për një moment tratativat për ta risjellë Ronaldon në Angli e zbehën interesin. Për uellsianin do të ishte një rikthim, pasi ka luajtur më parë edhe te Tottenhami. Bale nuk është i kënaqur me minutat që i janë dhënë te Reali i Madridit si dhe për formën e dobët që kaloi. Ky transferim do ta ndihmonte uellsianin të rikthehej si një futbollist i madh.

#### Daliqi: Askush nuk donte të dilte nga fusha

Kroacia bëri historinë duke siguruar finalen e Kampionatit Botëror pasi një triumfi 2-1 në shtesë ndaj Anglisë. Ajo që ra në sy te skuadra ballkanase ishte se deri në përfundim të kohës së rregullt nuk kishte kryer asnjë zëvendësim. Trajneri Daliq u shpreh se dëshironte të kryente zëvendësime, por dëshira e madhe e lojtarëve që kishin nisur ndeshjen e bëri atë të mos zëvendësonte asnjë prej tyre deri në minutën e 90. "Ajo që bëri lojtarët tanë treguan forcë dhe nivel energjie. Desha të bëja zëvendësime, por askush nuk donte të dilte. Të gjithë vazhdonin të thoshin: 'Mund të luaj, mund të vrapoj'. Disa lojtarë luajtën me lëndime të vogla, me të cilat nuk do të luanin në ndeshjet e tjera. Dy lojtarë luajtën me gjysmë këmbë, por kjo nuk u vërejt!", u shpreh trajneri pas ndeshjes.

#### Southgate: Meritonim të shkonim më larg

Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, ndihet krenar për grupin e lojtarëve që ai drejtoi në këtë Botëror. Sipas tij, Anglia e meritoi të shkonte në finale të këtij Botërori. "Tani për tani, të gjithë po e ndiejmë dhimbjen e humbjes. A kemi pritur të jemi në këtë fazë? Nuk besoj se dikush nga ne e ka pritur këtë. Mirëpo, kur arrin deri në këtë pikë dhe ke luajtur ashtu si kemi luajtur ne, dhe ashtu si luajtëm mirë në pjesën e parë, është dashur t'i shfrytëzojmë këto raste që të vijnë në jetë. Mirëpo, ajo që do të them është se jam jashtëzakonisht krenar me këtë grup lojtarësh, të cilët kanë përparuar shumë. Mendoj se reagimi i tifozëve ndaj tyre, krahasuar me dy vjet më parë, ua tregon këtë, se për herë të parë përvojat me Anglinë mund të jenë pozitive, vendi është shumë krenar me ta dhe me mënyrën si kanë luajtur, dhe me kalimin e kohës do t'i vlerësojmë shumë çaste pozitive", ka thënë Southgate.

Autor: Gazmend Morina - BENI	RESA	FILOZOF NË GREQINË ANTIKE	KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU	KËNGËTARJA ELI	AZEM GALICA	MENDJEHOLLË (shq.)	ISTRES	EPOKA E RE	DRAMË E FRANÇESK ANTON SANTORIT	FEMËR E PORSAMART- UAR	GJENDJA E VËSHITËRË, MUNDIMI QË VJEN NGA MUNGESA E DIÇKAJE KLINT ISTVUD	ZANOËRE	AKTORI YNË ADRIAN TONI ADAMS	LLOJ SHALE PREJ DRURI	SHTETI (fr.)				
KËNGËTARJA AMERIKANE GWEN								E PËRZJEVE KËNGËTARJA JONË ..... BITRI											
KLUB FUTBOLLI SPANJOLL							MUNGESË GJALLËRIE, ZHVILLIMI E PËRPARIMI KËNGËTARJA BRITANIKE UAJNHAUS					TOKË E PUNUAR (sh.shq.) DUKATI							
DRAMATURGU YNË GJOCAJ					"SPORTI I BARDHË"						ZANOËRE FALJE A ULJE E DËNIMEVE TË DHËNA NGA GJYQI		KËNGËTARJA PERUANE SUMAK EDUARD SANTER						
PJESË E DERËS					EMËR FEMRE MYSLIMANE KËNGËTARJA OKSA					FUSHËBETE- JAT ZANOËRE									
→				MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAJ FUTBOLLISTI I BARCELONËS SAMUEL						I DËRGUARI SPECIAL PËR ZGJIDHJEN E NJË KONFLIKTI PAKOJA									
PILOTI I "Formula 1" FELIPE	MASHTRIM ME DIÇKA TË PAQENË	AKTORI I FAMSHËM AFLEK (shq.) ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR .... BORIÇI					ANDORA LLOJ MINERALI		BASHKËTING-ËLLORE NATRIUM, FLUOR		NYNBERG KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE								
LLOJ INSEKTI I DOBISHËM						BASHKËTING-ËLLORE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË		HJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE (turq. - shq.) SHKRONJA E 18-të											
LLOJ LOJE FATI KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE XHONS					PËSHPËRIT FJALË MAGJIKE BASHKË, TOK														
→				PYLL SHKRONJA E 28-të				LLOJ VETURE ITALIANE RADIOLOKAT-OR											
FLORIDA, OHAJO			GRADË USHTARAKE					MODERATORI KRASTA SHKODRA, RIZONI, TROPOJA											
					PA U NXITUAR, NGADALË (turq.)					IPSVICH IVORY			KËNGËTARI AUSTRALIAN NË FOTO 1 KEITH						
					REPERI YNË ..... VULA						ZANOËRE KËNGËTARJA SHQIPTARE BOKA			METËR, ALUMIN	ALESANDRO NESTA	USHTAR I SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM NË KOHËN E TURQISË; REKRUT	SKUADËR	KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE	
					→					VITIRNË, DOLLAP (sh.shq.) KËNGËTARJA BARAKU									
					KUSAR SHENJA NDRËKOMB-ËTARE PËR KAMION				QYTET NË VERI TË KOSOVËS (shq.) MOTE										
					ELIABETH TAYLOR				QË KA TRUPTË SHËNDETSHËM LLAMBË NDRICIMI ME VAJGURI, FENER (krah.)						ZET, INDIUM KINDER (shk.)				
				TROYES		BIMË A PEMË E RE, NJOMËZ SHTAGA								E ZURA ME DORË, E ..... KONRAD ADENAUER LIBERTATES					
EPOKA E RE	ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ BERGKAMP	KRYEQYTETI KANADEZ	BËRJE MË I RI	ALBIN KURTI	I PESHOVA STRUGA					EMBLEMA			AKTORJA E FAMSHME BASIGNER VIGAN, KOLOS			GUXIMTARI	PREMTIM SOLEMN		
AI QË VRET DIKË ME DORËN E VET, GJAKËS						NËNË (turq.) GURRË, BURIM (sh.shq.)			KASOLLE E BARINJVE SUPER MODELJA KANADEZE XHESIKA							DY BASHKË- TINGËLLORE MBRET I TEBËS (pashq.)			
QË KA TË BËJË ME ETIKËN					PËREMËR VETOR ENDOKIA, XHAMAJKA, NAIROBI			MËNYRË E VEÇANTË E TË SHKRUARIT AUGSBURG							"EPOKA" KËNGËTARJA SKOCEZE LENOKS				
ADNAN (perkdh.)				PRINCIPATAT ARABË										ALBANOLOGIA DURHAM					
AKTORI I NJOHUR MONTAN (shq.)				ISH DISENJATORI ITALIAN VERSAÇI ARSENAL				MA JEP ZANOËRE						MINDERI I ULËT (vjet.) CEJLONI					
KËNGËTARJA BRITANIKE NË FOTO 2 FOKS	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	ÇLIRIM NGA VARËSIA, DALJE NGA TUTORIZIMI											



1

2

Lexus të nderuar, për vërejtje dhe sugjerime mund të shkruani në: fjalekryqi\_beni@yahoo.com & gazmend78@hotmail.com

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: H. M. STEFANI, E NAKATOSE, MALAGA, AMULLI, ARAT, LIRI, TENISI, A. IMA, REZA, KIM, DORAS, ANE, STAN, TB, ETIK, ATA, STIL, E RE, NAN, EMIRATET, EDIT, IVI, KHANI, AMA, NIMI, SAMANTA, EMANÇIPIM. LEDRI, U. PIRAT, ORMANET, TIR, ALBANIKU, ET, VITAL, ZIN, I, FIDAN, KAPA, I MATRA, KIM, DORAS, ANE, STAN, TB, ETIK, ATA, STIL, E RE, NAN, EMIRATET, EDIT, IVI, KHANI, AMA, NIMI, SAMANTA, EMANÇIPIM.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Administratës Publike**  
**Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration**

## K O N K U R S

Në bazë të Nenit 14 të LIGJI Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

### Titulli i vendit të punës:

Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

### KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe Neni 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
  - në administrim të biznesit;
  - financa të korporatave;
  - financa publike ;
  - menaxhim thesari;
  - banka;
  - biznes konsultimesh;
  - industri ose
  - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në rast të numrit të lartë të aplikacioneve, kriteret e mëposhtme të dëshirueshme do të përdoren për të vlerësuar aplikacionet, me ç' rast kandidatët e pasuksesshëm do të eliminohen në fazën e shqyrtimit të CV-ve në procesin e rekrutimit:

Diplomë Bachelor

Diplomë Master,

Kualifikimi profesional pas –diplomimit,

Anëtarë i një shoqate profesionistësh të pranuar në nivel kombëtar

Përvoja e punës në institucione/projekte ndërkombëtare,

Përvoja e punës në pozitë drejtori ekzekutiv,

Aftësia për të folur dhe të shkruar rrjedhshëm një gjuhë të huaj.

### KUSHTET

Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Ka qenë i dënuar dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

**Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:**

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose cilëso nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulus të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

### AFTESITE PERSONALE TE KËRKUARA

- Udhëheqje

- Pune ekipore
- Përdorimi i internetit
- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

### KOHËZGJATJA E MANDATIT:

Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, zyra nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net> Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 30 185.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit, përcaktohen nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik. .

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 13 korrik deri me 11 qershor 2018).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Data Systems" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë me erë (31.2 MW) "Mareci" në Marevcë dhe Kukavicë , komuna e Prishtinës.

Njoftohet Publiku i Interesuar se me datën 01. 08. 2018. në ora 11:00 ne hapësirat e restorantit „Vila Natyra” afër rrugës magjistrale Prishtine –Gjilan, në Mramor, komuna e Prishtinës, do të organizohet debat publik nga Kompania "Data Systems" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë me erë (31.2 MW) "Mareci" në Marevcë dhe Kukavicë , komuna e Prishtinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018  
deri më 10.03.2018**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**